



AKTI THEMELIMI  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"OL VAHROM"sh.p.k

I hartuar me vullnetin e paleve:

Ilia Bostanxhiu, banues ne Gjirokaster.

Besnik Kruja, banues ne Tirane me permbajtjen e meposhteme:

Neni 1. Krijohet shoqerija me pergjegjesi te kufizuar me emertimin  
"OL VAHROM"sh.p.k.

Neni 2. Ortakte themelues te saj jane Ilia Bostanxhiu dhe Besnik Kruja

Neni 3. Objekti i veprimtarise se saj eshte: Prodhim konfeksione, import  
export konfeksione dhe rroba te gateshme, import export bojrash  
tretes bojrash, tregeti e pergjitheshme import export.

Neni 4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100;000 leke.

Neni 5. Kontributi per krijimin e tij eshte per secilin ortak ne masen  
prej 50%. Ne po kete perqindje ndahet edhe fitimi midis tyre.

Neni 6. Administratori i saj eshte Ilia Bostanxhi.

Neni 7. Qendra e veprimtarise eshte ne Gjirokaster, lagja 18 shtatori.

Neni 8. Kohezgjatja e veprimtarise eshte 10 vjet.

Neni 9. Organi me i larte i shoqerise eshte Mbledhja e Ortakeve. Menyrat  
e mbledhjes se saj dhe marrjes se vendimeve percaktohen ne sta  
tut.

Neni 10. Shoqeria nuk pergjigjet per humbjet e ortakeve jashte veprimta  
rise se saj.

Neni 11. Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne rruge tra  
sheqimije dhe midis bashkeshorteve si dhe ne persona te trete

Neni 12. Shoqeria ka te drejte te krijojte degje dhe filiale te saj ne  
rrethet e vendit dhe jashte tij.

Neni 13. Shoqeria ka te drejte te punesoje punojes me te cilet lidh ko  
ntrata pune sipas ligjit perkates.

Neni 14. Kompetencat e administratorit percaktohen ne statutin e shoqer  
ise.

Neni 15. Mosmarveshjet midis paleve nese nuk zgjidhen me pajtim, jane ne  
kompetence te gjykates se rrethit Tirane.

Neni 16. Personalitetin juridik te saj shoqerija e fiton me rregjistri  
min e saj ne gjykatën e rrethit Tirane, prane Rregjistrimit Tregje  
tar.

Akti themelimit nenshkruhet nga palet pa asnje verejtje.

ORTAKET

Ilia Bostanxhiu  
Bostanxhiu

Besnik Kruja  
BK



STATUTI I SHOQERISE  
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME EMERTIMIN  
"OL -VAHROM"

I hartuar me vullnetin e lire te paleve:

Ilia Bostanxhiu,banues ne Gjirokaster dhe Besnik Kruja,banues ne Tirane.

Neni 1.

Krijohet shoqerija me pergjegjesi te kufizuar me emertimin,"OL-VAHROM"sh.p.k.si person juridik privat per te ushtruar veprimtari private tregtare me qellim fitimprures dhe ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 2

Objekti I veprimtarise se saj eshte.Prodhim konfeksione,import export konfeksionesh dhe rroba te gateshme,import export bojrash,tretes bojrash,tregeti pergjitheshme import export.

Neni 3.

Ortaket themelues te kesaj shoqerije jane.Ilia Bostanxhi dhe Besnik Kruja.

.Neni 4.

Qendra e veprimtarise se shoqerise eshte ne Gjirokaster,lagja 18 shtatori.

Neni 5.

Kapitali themeltar I shoqerise eshte ne vlere 100.000 leke. Kontributi ortakeve ne krijimin e kapitalit themeltar te saj eshte perkatesisht per secilin ortak ne masen prej 50%.

Neni 6.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte 10 vjet.Personaliteti juridik I shoqerise fitohet me rregjistrimin e saj ne Rregjistrin Tregetar,prane gjykates se rrethit Tirane.

Neni 7.

Organi me I larte I shoqerise eshte Mbledhja e Ortakeve,Ortaket mblidhen ne mbledhje te zakonshme dhe te jashtezakonshme.Ne mbledhjet e saj te zakonshme, shoqeria mblidhet tre here ne vit.Drejtimi I tyre kryhet nga Administratori I shoqerise.Te drejten e thirrjes se mbledhjes e kane edhe ortaket qe perfaqesojne te pakten 10% te pjeseve te kapitalit themeltar.Mbledhjet e Ortakeve,jane te rregullta nese ne to marrin pjese te gjithë ortakët ose nepermjet perfaqesuesve te tyre sipas rregullave te perfaqesimit,por duke specifikuar per cdo rast tagret e perfaqesimit sipas rendit te dites.

Vendimet ne mbledhjen e zakonshme te ortakeve,merren, nese per to, votohet nga ortakët qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.Cdo ortak disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e tij ne kontributin per krijimin e kapitalit themeltar.

Per ndryshimet ne statutin e shoqerise,vendimet jane te vlefshme nese per to votohet nga ortakët qe perfaqesojne 3/4e pjeseve te kapitalit themeltar.



Kompetencat kryesore të Mbledhjes së Ortakeve janë:  
vendos për strukturat organizative të shoqërisë, emeron, ose shkarkon administratorin e shoqërisë,  
emeron ose shkarkon ekspertin kontabel të autorizuar,  
vendos për bashkim, ndarje, të shoqërisë, për krijim dege apo filiali të saj,  
për dhenie, marrje me qera ose shitje të pronave të saj,  
për dhenie ose marrje të kredive në emër të shoqërisë,  
për prishje të shoqërisë, para mbarimit të afatit për caktuar në statut dhe, përgjithësisht ushtron kompetencat e percaktuara në dispozitat përkatëse nën 57 ligjit 7638 datë 19.11.1992.

Neni 8.

Drejtimi i shoqërisë kryhet nga administratori i saj, i cili emërohet nga mbledhja e parë e ortakeve dhe është zoti: Ilia Bostanxhi.

Ai ushtron kompetencat e dhëna nga statuti dhe ato sipas nenit 50 të Ligjit 7638 datë 19.11.1992, me përjashtim të atyre që i janë lënë Mbledhjes së Ortakeve.

Administratori ushtron veprimtarinë e tij, duke përfaqësuar shoqërinë në marrëdhënie me të tjerë dhe detyrimet që ai merr ndaj të tjerëve në emër të shoqërisë, qëhen të mirëqena nga shoqëria. Administratori detyrohet të respektojë procedurat e njoftimit të mbledhjes së ortakeve; duke njoftuar 15 ditë më parë dhe rendin e ditës së mbledhjes, drejton atë si dhe paraqet raportin e llogarive përfundimtare vjetore apo çdo projekt të hartuar nga eksperti kontabel i emëruar nga mbledhja e ortakeve.

Te drejten e shkarkimit të Administratorit në rast shkelje ligjore të tij, për veprime që bien ndesh me statutin dhe i kanë shkaktuar dëm material shoqërisë, e ka çdo ortak me vete duke ju drejtuar gjykatës kompetente.

Vendimin për shkarkim të administratorit e merr Mbledhja e Ortakeve, kur për këto votojnë ortaket që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të saj.

Neni 9.

Fitimi që rezulton nga aktiviteti i shoqërisë, ndahet midis ortakeve pasi me parë të jenë zbritur nga të ardhurat shpenzimet e nevojshme, si detyrime ndaj të tjerëve, taksat etj. Pjesët e fitimit përcaktohen sipas kontributit të pjesëve për krijimin e kapitalit themeltar dhe përkatësisht për secilin ortak: Ilia Bostanxhi 50% dhe Besnik Kruja 50%. Përballen humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerave të kontributit të secilit ortak për krijimin e kapitalit themeltar.

Neni 10.

Palet bien dakort që nga pjesa e fitimit të krijojnë fondin rezervë, i cili do të shërbejë për kapitalizim të fitimeve, përballim të nevojave të domosdoshme etj. Ky fond nuk është i detyrueshëm kur arrihet në 1/10 e kapitalit të shoqërisë.

Neni 11.

Shoqeria ka te drejte te lidhe kontrata pune me personat e punesuar ne baze te legjislacionit perkates ne fuqi.

Neni 12.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme, midis ortakeve, ne rruge trashegimije edhe bashkeshortore. Per transferimin e tyre midis ortakeve zbatohen kerkesat e nenit 47 dhe 49 te ligjit 7638, por per transferimin e pjeses se ortakut ne persona te trete, nevojitet tu jete bere I ditur atyre projekti nga ortaku shites. Nese nuk pergjigjen per kete projekt brenda tre muajve, transferimi konsiderohet I miratuar prej tyre.

Neni 13.

Shnderimi I shoqerise ne nje forme tjeter behet me vendimin unanim te ortakeve. Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit themeltar te saj, (si ndryshim ne statut), behet pasi te jete votuar per kete, nga ortakët qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar

Neni 14

Shoqeria priset ne kuptim te ligjit 7638 dates 19.11.1992 kur:

- a) mbaron afati parashikuar ne statut
- b) ky vendim merret me vullnetin e ortakeve ne mbledhjen e tyre, para mbarimit te afatit parashikuar ne statut.

Neni 15.

Kompetente per gjykimin e mosmarveshjeve midis ortakeve eshte gjykata e rrethit Tirane.

Sa me siper statuti nenshkruhet nga palet pa snje verejtje.

### ORTAKET

ILIA BOSTANXHIU

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
Nr 315 rep 38 kol

BESNIK KRUIJA.

### VERTETIM

Ne Tirane sot ne date 4/04/2000, ne zyren e noterise para meje noter J. Heli, u paraqiten Ilia Bostanxhiu, biri I Vasilit, dl. 1960, banues ne Gjirokaster, dhe Besnik Kruja, biri I Sulejmanit, dl. 1960, lindur dhe banues ne Tirane, per identitetin e te cileve u njoha ne baze te ligjit, te afte per te kryer veprime juridike qe kerkuan nga une vertetim te nenshkrimeve te tyre sa me siper. Pasi u binda per vullnetin e tyre te lire vertetoj rregullisht.

NOTERE

